UDHËZIM
Nr. 913, datë 27.12.2018

MBI PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE, PROCEDURAVE DHE AFATEVE TË VLEFSHMËRISË SË LICENCAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË FURNIZIMIT ME KARBURANT PËR KONSUM TË ANIJEVE NË PORTE DHE NË RADA (KODI VII.5.7)

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 401, germa "b", e ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", si dhe të VKM-së nr. 538, datë 26.5.2009, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. PROCEDURA E DHËNIES SË LICENCAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIM-TARISË SË FURNIZIMIT ME KARBURANT, PËR KONSUM, TË ANIJEVE NË PORTE DHE NË RADA

1. Veprimtaria e furnizimit me karburant, për konsum, të anijeve në porte dhe në rada bëhet vetëm nga shoqëritë tregtare, pasi të jenë pajisur me "Licencë për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit me karburant, për konsum, të anijeve në porte dhe në rada" nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë udhëzim dhe VKM-në nr. 538, datë 26.5.2009, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", i ndryshuar.

2. Licenca "Për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit me karburant, për konsum, të anijeve në porte dhe në rada", është e nënkategorisë VII.5.7, trajtohet sipas grupit III dhe lëshohet për një afat 5- (pesë-) vjeçar.

3. Licenca "Për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit me karburant, për konsum, të anijeve në porte dhe në rada", me kodin VII.5.7, përfshin ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit me karburant, për konsum, të anijeve në porte dhe në rada me anë të autoboteve, dhe/ose me anë të anijeve cisternë.

4. Licenca "Për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit me karburant, për konsum, të anijeve në porte dhe në rada", me kodin VII.5.7, ndahet në dy lloje:

a) Lloji "A" - i cili përfshin ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit me karburant, për konsum, të anijeve vetëm në porte; dhe

b) Lloji "B" - i cili përfshin ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit me karburant, për konsum, të anijeve në porte dhe në rada.

5. Personat juridikë/fizikë paraqesin në QKB kërkesën për t'u pajisur me licencë të kategorisë VII.5.7 të llojit "A", shoqëruar nga dokumentet si më poshtë:

a) Formularin e autodeklarimit;

b) Ekstraktin historik dhe tregtar të regjistrit tregtar, nga Qendra Kombëtare e Biznesit, ku objekt të veprimtarisë të ketë tregtimin e karburantit dhe furnizimin me karburant të mjeteve lundruese;

c) Licencë të kategorisë VIII.1.A për tregtimin me shumicë të naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio, si dhe lëndëve djegëse;

d) Kontratë punësimi me një drejtues teknik të licencuar i shoqëruar me dokumentacionin provues;

e) Dokumentacion që provon pronësinë ose kontratën e qirasë për 5 (pesë) automjete tokësore tip autobot për furnizimin e anijeve në kalatë i shoqëruar me dokumentacionin si më poshtë:

i. leja e qarkullimit;

ii. certifikata e kontrollit të fundit teknik;

iii. certifikatën e miratimit ADR të mjetit;

f) Vërtetimin e pronësisë ose kontratën e qirasë për depozitat, që do të përdorë personi juridik, me kapacitet jo më pak se 2000 (dy mijë) m^3. Personi juridik nuk mund të marrë me qira kapacitete depozituese, në qoftë se ato janë në përdorim nga qiradhënësi apo nga ndonjë person i tretë, si dhe kapacitete depozituese të rafinerive të naftës dhe impianteve të përpunimit të nënprodukteve të naftës, të cilat janë në funksion të procesit teknologjik dhe kanë infrastrukturë të përbashkët me rafinerinë; kohëzgjatja e kontratës së qirasë të jetë jo më pak se 5 (pesë) vjet nga data e aplikimit;

g) Projektin teknologjik të depove dhe të linjat përkatëse teknologjike, që realizojnë funksionimin e tyre, të miratuar nga organet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi të mjedisit dhe të mbrojtjes nga zjarri;

h) Certifikatën e përdorimit, të lëshuar nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit për depozitat dhe linjat përkatëse teknologjike, që realizojnë funksionimin e tyre;

i) Certifikatën e kalibrimit të vëllimit të depove, nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose organet e autorizuara për këtë qëllim;

j) Policë Sigurimi me vlerë primi jo më pak se 1.000.000 euro për shpërblimin ndaj dëmeve që mund t'u shkaktohen të tretëve gjatë operacioneve të bunkerazhit e vlefshme përgjatë gjithë kohëzgjatjes së licencës;

k) Plan Emergjence për reagimin ndaj ndotjes detare të miratuar nga institucionet përkatëse në zbatim të VKM-së nr. 480, datë 25.7.2012;

l) Kontratë shërbimi me operatorë ekonomik që ofrojnë shërbimin për reagimin ndaj ndotjes detare ose deklaratë që ka në pronësi pajisje reaguese (vërtetuar nëpërmjet faturave dhe fotografive përkatëse), si: kosh depozitues, shirit kufizues; peceta absorbuese, veshje sigurie personale, qese plastike me ngjyrë të verdhë etj.;

m) Vërtetimin për kontrollin e objektit, për respektimin e kushteve teknike, të lëshuar nga organet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Personat juridikë/fizikë që kërkojnë për t'u pajisur me licencë të kategorisë VII.5.7 të llojit "B", duhet të paraqesin në QKB përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 5 më sipër dhe dokumentet shoqëruese, si më poshtë vijon:

a) Dokumentacion që provon pronësinë ose kontratën e qirasë të një mjeti lundrues tanker me kapacitet transportues mbi 100 DWT, i cili të jetë ndërtuar, klasifikuar dhe i pajisur me dokumentacionin e nevojshëm teknik për mbajtjen, transportin dhe furnizimin me karburant të anijeve në radë i shoqëruar me dokumentacionin si më poshtë:

i. dokument që vërteton pronësinë e mjetit lundrues (dëshmi pronësie, dëshmi flamuri ose dëshmi e aftësisë së lundrimit për mjet të vogla) lëshuar nga DPD-ja. Në rastet kur mjeti lundrues merret me qira kontratën e qirasë për një periudhë jo më pak se 5 vjet nga dita e aplikimit;

ii. certifikata e klasit e lëshuar nga shoqëria klasifikuese, e cila të jetë klasifikuar si anije tanker;

iii. dokument nga shoqëria klasifikuese që provon se kapaciteti transportues i mjetit lundrues të jetë mbi 100 DWT;

iv. policë sigurimi për shpërblimin ndaj dëmeve që mund të shkaktohen të tretëve nga anija;

v. policë sigurimi në zbatim të Konventës Ndërkombëtare për Heqjen e Anijeve të Mbytura (WRC 2007);

vi. certifikatat e trajnimin të ekuipazhit për familjarizimin me anijen tanker, të lëshuara nga administrata detare në zbatim të Konventës STCW, rregulli V.1.1, seksioni V.1.1.1 ose V.1.1.2.

7. Gjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së licencës së tregtimit, shoqëria e tregtimit me shumicë ka detyrimin të furnizohet në magazina të miratuara doganore dhe të zbatojë legjislacionin fiskal dhe doganor në fuqi.

8. Gjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së licencës së tregtimit, shoqëria e tregtimit me shumicë ka

detyrimin të ketë kontratë punësimi të vlefshme me një drejtues teknik të licencuar.

II. PROCEDURA DHE AFATET E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS PËR LICENCIM

1. Shqyrtimi i dokumentacionit të plotë për marrjen e licencës për furnizimin me karburant për konsum, të anijeve në porte dhe në rada nga personi juridik, trajtohet nga ministria përgjegjëse për transportin detar sipas dispozitave të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe VKM-së nr. 538, datë 26.5.2009, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar.

2. Pas ardhjes së kërkesës nga QKB-ja, struktura përgjegjëse në Ministri shqyrton përmbushjen e kritereve të licencimit, vlerëson aplikimin e bërë nga shoqëria dhe informon QKB-në për vendimmarrjen.

3. Struktura përgjegjëse në Ministri, pas shqyrtimit, vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës së paraqitur nga subjekti brenda një afati 20 (njëzet) ditë pune.

4. Në rastet kur struktura përgjegjëse nuk mund të marrë vendimin brenda afatit të kërkuar, mund të shpallë në regjistrin e QKB-së shtyrjen e afatit për rastin përkatës, duke dhënë arsyet e kësaj shtyrje.

5. Në rast se strukturat e përcaktuara në pikën 10 vlerësojnë se kërkesa nuk përmbush të gjitha kushtet e parashikuara në kreun I të këtij udhëzim, refuzon kërkesën dhe informon QKB-në për vendimmarrjen dhe mangësitë e aplikimit.

III. ZBATIMI I KUSHTEVE TEKNIKE

1. Subjektet që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e furnizimit me karburant, për konsum, të anijeve në porte dhe në rada, pas licencimit zbatojnë detyrimet e dala nga konventat ndërkombëtare, "Kodin Detar" dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

2. Subjektet e licencuara janë objekti i zbatimit të rregullave të shërbimit të sigurt të bunkerazhit, të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme Detare.

3. Kushtet teknike janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha subjektet që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e furnizimit me karburant, për konsum, të anijeve në porte dhe në rada. Pajisja e këtyre subjekteve me vërtetim teknik realizohet sipas kushteve dhe procedurave të miratuara nga ministri përgjegjës për hidrokarburet.

4. Vërtetimi për kontrollin e objektit, për respektimin e kushteve teknike, i lëshuar sipas pikës së mësipërme rinovohet çdo 1 (një) vit. Në rast se ky vërtetim nuk rinovohet, Inspektorati Shtetëror Përgjegjës zbaton procedurat e parashikuara në nenin 25, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, duke propozuar ndërmjet të tjerave edhe revokimin e licencës.

5. Subjektet që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e furnizimit me karburant, për konsum, të anijeve në porte dhe në rada janë të detyruara të zbatojnë sistemin e taksave dhe tatimeve dhe kodin doganor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

6. Ministria që mbulon veprimtarinë e transportit detar dhe atë hidrokarbure publikojnë kushtet teknike.

IV. DISPOZITA TË TJERA

1. Bllokimi i përkohshëm i veprimtarisë së furnizimit me karburant, për konsum, të anijeve në porte dhe në rada bëhet në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 28, të Kodit Detar, si dhe të pikës 3, të nenit 25, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar.

2. Revokimi i licencës së furnizimit me karburant, për konsum, të anijeve në porte dhe në rada për subjektet e licencuara bëhet në përputhje me përcaktimet e neneve 12 e 29, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3. Ngarkohen strukturat përkatëse pranë Ministrisë se Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme Detare dhe Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në zbatimin e këtij udhëzimi.

4. Ky udhëzim i njoftohet QKB-së, Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë.

Ky udhëzim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi 2 (dy) muaj nga ky botim.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjiknuri